Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

RREGULLORE Nr. XX/2018 QË NDRYSHON RREGULLOREN NR. 07/2015 LIDHUR ME LEHTËSIMIN E PROCEDURAVE TË MIRËMBAJTJES PËR MJETET AJRORE TË AVIACIONIT TË PËRGJITHSHËM

UREDBU BR. XX/2018 O IZMENI UREDBE BR. 07/2015 U ODNOSU NA OLAKŠAVANJE POSTUPAKA ODRŽAVANJA ZA VAZDUHOPLOVE OPŠTEG VAZDUHOPLOVSTVA

REGULATION NO. XX/2018 AMENDING REGULATION NO 07/2015 AS REGARDS ALLEVIATIONS FOR MAINTENANCE PROCEDURES FOR GENERAL AVIATION AIRCRAFT

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës, Në mbështetje të neneve 3.5 pika (i), 15.1 pika (a), (c), (e), (j) në lidhje me nenin 45 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Viti III, Nr. 28, datë 4 qershor 2008), Duke marrë parasysh, Detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës drejt Marrëveshjes Shumëpalëshe për Krijimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (në tekstin e mëtejmë "Marrëveshja HPEA") që prej hyrjes së saj të përkohshme në fuqi në Kosovë më 10 tetor 2006, Me qëllim të zbatimit të Rregullores së Komisionit (KE) Nr. 452/2014 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative lidhur me operimet ajrore të operatorëve të vendeve të treta në pajtim me Rregulloren (KE) Nr. 216/2008 të	Generalni direktor Autoriteta civilnog vazduhoplovstva Republike Kosovo, U skladu sa članovima 3.5 tačka (i), 15.1 tačka (a), (c), (e), (j) u vezi sa članom 45. Zakona br. 03/L-051 o civilnom vazduhoplovstvu („Službeni list Republike Kosovo", godina III, br. 28, od 4. juna 2008), Uzimajući u obzir, Međunarodne obaveze Republike Kosovo u skladu sa multilateralnim sporazumom o osnivanju Zajedničkog evropskog vazduhoplovnog prostora (u daljem tekstu „Sporazum ECAA") od njenog privremenog stupanja na snagu za Kosovo 10. oktobra 2006., U cilju sprovođenja Uredbe Komisije (EK) BR. 452/2014 kojom se utvrđuju tehnički zahtevi i administrativne procedure u vezi sa vazduhoplovnim operacijama operatora iz trećih zemalja u skladu sa Uredbom (EK) br. 216/2008 Evropskog parlamenta i Saveta, izmenjena Uredbom Komisije (EK)	Director General of Civil Aviation Authority of the Republic of Kosovo, Pursuant to Articles 3.5 item (i), 15.1 item (a), (c), (e), (j) in connection with article 45 of the Law No. 03/L-051 on Civil Aviation ("Official Gazette of the Republic of Kosovo", Year III, No. 28, of 4 June 2008), Taking into consideration, International obligations of the Republic of Kosovo towards Multilateral Agreement on Establishing the European Common Aviation Area (hereinafter "ECAA Agreement") since its provisional entry into force for Kosovo on 10 October 2006, With the aim of implementing Commission Regulation (EC) No 452/2014 laying down technical requirements and administrative procedures related to air operations of third country operators pursuant to Regulation (EC) No 216/2008 of the European Parliament and of the Council,

Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, ndryshon Rregulloren e Komisionit (KE) Nr. 2016/1158, duke ndryshuar Rregulloren (KE) Nr. 452/2014 për fshirjen e formularëve për autorizimet e lëshuara për operatorët e vendeve të treta dhe për specifikimet përkatëse. Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik me të gjitha palët e interesuara në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2012 për konsultimin publik të palëve të interesuara, Nxjerr këtë: **RREGULLORE Nr. XX/2018 QË NDRYSHON RREGULLOREN NR. 07/2015 LIDHUR ME LEHTËSIMIN E PROCEDURAVE TË MIRËMBAJTJES PËR MJETET AJRORE TË AVIACIONIT TË PËRGJITHSHËM**	2016/1158, kojom se menja Uredba (EK) Br. 452/2014 u vezi s brisanjem obrazaca za ovlašćenja izdata operatorima trećih zemalja i za pripadajuće specifikacije. Nakon završetka procesa javnih konsultacija sa zainteresovanim stranama, u skladu sa Administrativnim uputstvom br. 01/2012 o procedurama javnih konsultacija sa zainteresovanim stranama, Donosi sledeću: **UREDBU BR. XX/2018 O IZMENI UREDBE BR. 07/2015 U ODNOSU NA OLAKŠAVANJE POSTUPAKA ODRŽAVANJA ZA VAZDUHOPLOVE OPŠTEG VAZDUHOPLOVSTVA**	amended by Commission Regulation (EC) 2016/1158, amending regulation (EC) No 452/2014 as regards the deletion of templates for the authorisations issued to third country operators and for the associated specifications. Upon completion of the process of public consultation of interested parties, in accordance with the Administrative Instruction No. 01/2012 on procedures for public consultation of interested parties, Hereby issues the following: **REGULATION NO. XX/2018 AMENDING REGULATION NO 07/2015 AS REGARDS ALLEVIATIONS FOR MAINTENANCE PROCEDURES FOR GENERAL AVIATION AIRCRAFT**

Neni 1	*Član 1.*	*Article 1*
Rregullorja Nr. **XX/2018** ndryshohet si në vijim:	Uredba br **XX/2018** menja se kako sledi:	Regulation **No XX/2018** is amended as follows:
(1) Në Nenin 2, pika në vijim (ka) vendoset pas pikës (k):	(1) U članu 2. ubacuje se sledeća tačka (ka) nakon tačke (k):	(1) In Article 2, the following point (ka) is inserted after point (k):
'(ka) "MLAE2" nënkupton mjetin ajror të lehtë evropian te drejtuar nga njeriu:	'(ka) „Vazduhoplov ELA2" znači sledeći evropski laki vazduhoplov sa posadom:	'(ka) "ELA2 aircraft" means the following European Light Aircraft:
(i) Një mjet ajror me masë maksimale të ngritjes (MTOM) prej 2.000 kg ose më pak, që nuk klasifikohet si mjet ajror me motor të ndërlikuar; (ii) fluturuese me planer ose fluturuese planer me masë prej 2.000 kg MTOM ose më pak; (iii) balonën; (iv) fluturake me ajër të nxehtë; (v) fluturake me gaz që është në përputhje me të gjitha karakteristikat e mëposhtme: — 3 % e peshës maksimale statike, — Shtytje jo-vektoriale (përveç shtytjes së prapme), — konstruksion me strukturë konvencionale dhe të thjeshtë, sistem të kontrollit dhe sistem të balonave, dhe	(i) Vazduhoplov čija je najveća dopuštena masa pri uzletanju (MTOM) 2 000 kg ili manje koji nije razvrstan kao kompleksni vazduhoplov na motorni pogon; (ii) jedrilica ili jedrilica sa pomoćnim motorom čiji je MTOM 2 000 kg ili manje; (iii) balon; (iv) vazdušni brod uz pogon na topao vazduh; (v) vazdušni brod uz pogon na plin, koji je u skladu sa sledećim karakteristikama: — 3 % maksimalne statičke težine, — ne-vektorski potisak (osim povratnog potiska), — konvencionalan i jednostavan projekat konstrukcije, kontrolnog sistema i sistema baloneta, i	(i) An aeroplane with a Maximum Take-off Mass (MTOM) of 2 000 kg or less that is not classified as complex motor-powered aircraft; (ii) a sailplane or powered sailplane of 2 000 kg MTOM or less; (iii) a balloon; (iv) a hot air ship; (v) a gas airship complying with all of the following characteristics: — 3 % maximum static heaviness, — non-vectored thrust (except reverse thrust), — conventional and simple design of structure, control system and ballonet system, and — non-power assisted controls; (vi) a Very Light Rotorcraft.'

— kontrollet e asistuara pa energji; (vi) Fluturake shumë e lehtë me helikë.'	— komande bez serva; (vi) vrlo laki rotokopter.“	
(2) Në nenin 3, është shtuar paragrafi 4 si në vijim:	(2) U članu 3. dodaje se sledeći stav 4:	(2) In Article 3, the following paragraph 4 is added:
'4. Programet e mirëmbajtjes, të aprovuara në përputhje me kërkesat e zbatueshme para 27 korrikut 2015, konsiderohen si të aprovuara në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë Rregullore.'	„4. Programi održavanja odobreni u skladu sa zahtevima koji su se primenjivali pre 27. jula 2015. smatraju se odobrenim u skladu sa zahtevima utvrđenim u ovoj Uredbi.“	'4. Maintenance programmes approved in accordance with the requirements applicable before 27 July 2015 shall be deemed to have been approved in accordance with the requirements set out in this Regulation.'
(3) Neni 8 ndryshohet si në vijim:	(3) Član 8. menja se kako sledi:	(3) Article 8 is amended as follows:
(a) në paragrafin (2)(b), data '28 shtator 2015' zëvendësohet me datën '28 shtator 2016'; (b) në paragrafin (4), Rregullorja Nr. 07/2015 (Rregullorja (KE) Nr. 2042/2003) zëvendësohet me (Rregulloren (BE) Nr. 1149/2011); (c) është shtuar paragrafi (6) si në vijim:	(a) u stavu 2(b) datum „28. septembar 2015.“ zamenjuje se datumom „28. septembar 2016; (b) u stavu 4. Uredba br 07/2015 (Uredba (EZ) br. 2042/2003) zamenjuje se sa (Uredba (EU) br. 1149/2011); (c) Dodaje se sledeći stav (6):	(a) in paragraph (2)(b), the date of '28 September 2015' is replaced by the date of '28 September 2016'; (b) in paragraph (4), Regulation No 07/2015 (Regulation (EC) No 2042/2003) is replaced by (Regulation (EU) No 1149/2011); (c) The following paragraph (6) is added:
'6. Duke iu shmangur paragrafit 1:	'6. Odstupajući od stava 1:	'6. By way of derogation from paragraph 1:
(a) Autoritetet kompetente ose, aty	(a) nadležna tela ili, prema potrebi, organizacije mogu nastaviti sa	(a) Competent authorities or, where

ku është e aplikueshme, organizatat mund të vazhdojnë të lëshojnë certifikata, ose të lëshuara më herët, siç përcaktohet në Shtesën III të Shtojcës I (Pjesa-M) ose Shtesën II dhe Shtesën III të Shtojcës IV (Pjesa-147) të Rregullores 07/2015 (Rregullores (BE) Nr. 1321/2014), e cila ka hyrë në fuqi para datës 27 korrik 2015 deri më 31 dhjetor 2015. (b) Certifikatat e lëshuara para datës 1 janar 2016 mbesin të vlefshme derisa ato të ndryshohen, pezullohen ose revokohen.' (4) Shtojca I (Pjesa -M) është ndryshuar në pajtim me Shtojcën I të kësaj Rregullore. (5) Shtojca II (Pjesa -145) është ndryshuar në pajtim me Shtojcën II të kësaj Rregullore. (6) Shtojca IV (Pjesa -147) është ndryshuar në pajtim me Shtojcën III të kësaj Rregullore.	izdavanjem sertifikata, prethodno izdavanje, kako je utvrđeno u Dodatku III Aneksu I (deo M) ili Dodatku II i Dodatku III Aneksu IV (deo 147) Uredbi (EU) br. 1321/2014, na snazi pre 27. jula 2015. do 31. decembra 2015. (b) sertifikati izdati pre 1. februara 2016. ostaju važeće dok se ne promene, privremeno ili trajno oduzmu." (4) Aneks I (Deo-M) menja se u skladu sa Aneksom I ove Uredbe. (5) Aneks II (Deo-145) menja se u skladu sa Aneksom II ove Uredbe. (6) Aneks IV (Deo-147) menja se u skladu sa Aneksom III ove Uredbe.	applicable, organisations may continue to issue certificates, previous issue, as laid down in Appendix III to Annex I (Part-M) or Appendix II and Appendix III to Annex IV (Part-147) to Regulation (EU) No 1321/2014, in force prior to 27 July 2015, until 31 December 2015. (b) Certificates issued before 1 January 2016 remain valid until they are changed, suspended or revoked.' (4) Annex I (Part-M) is amended in accordance with Annex I to this Regulation. (5) Annex II (Part-145) is amended in accordance with Annex II to this Regulation. (6) Annex IV (Part-147) is amended in accordance with Annex III to this Regulation.

Neni 2 **Hyrja në fuqi** Kjo Rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas nënshkrimit të saj. Prishtinë, **05.04.2018.** _____ **Dritan Gjonbalaj** Drejtor i përgjithshëm	*Član 2.* **Stupanje na snagu** Ova Uredba stupa na snagu petnaest (15) dana nakon potpisivanja. Sačinjeno u Prištini, **05.04.2018.** _____ **Dritan Gjonbalaj** Generalni direktor	*Article 2* **Entry into Force** The present Regulation shall enter into force fifteen (15) days upon its signature. Done at Prishtina, **05.04.2018.** _____ **Dritan Gjonbalaj** Director General

SHTOJCA I

Shtojca I (Pjesa-M) e Rregullores (BE) Nr. 1321/2014 është ndryshuar si në vijim:

(1) Tabela e përmbajtjes është ndryshuar si në vijim:

(i) pika M.A.607 zëvendësohet nga si në vijim:

'M.A.607 Stafi i Certifikimit dhe stafi për shqyrtimin e përshtatshmërisë së operimit ajror'

(ii) pika M.A. 614 zëvendësohet nga si në vijim:

'M.A.614 Regjistrat e mirëmbajtjes dhe shqyrtimit të përshtatshmërisë së operimit ajror'

(2) Pika M.A.201 është ndryshuar si në vijim:

(i) pikën (a), pika 4 zëvendësohet nga si në vijim:

'4. Mirëmbajtja e avionëve kryhet në përputhje me programin e mirëmbajtjes, siç është specifikuar në pikën M.A.302.';

(ii) pika (e) zëvendësohet nga si në vijim:

'(e) Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësive të pikës (a),

(i) pronari i një avioni mund të kontraktojë detyrat që lidhen me përshtatshmërinë e vazhdueshme të operimit ajror me një organizatë për menaxhimin e përshtatshmërisë së vazhdueshme të operimit ajror të miratuar në përputhje me Seksionin A, Nën-pjesën G të kësaj Shtojce (Pjesa M). Në këtë rast, organizata për menaxhimin e përshtatshmërisë së vazhdueshme të operimit ajror merr përgjegjësinë për përmbushjen e duhur të këtyre detyrave. Në këtë rast përdorët kontrata e përshkruar në Shtesën I;
(ii) një pronar që vendos të menaxhojë përshtatshmërinë e vazhdueshme të operimit ajror të avionit nën përgjegjësinë e tij, pa kontratë në përputhje me Shtesën I, megjithatë mund të bëjë një kontratë të kufizuar për zhvillimin e programit të mirëmbajtjes dhe procedimin e miratimit të tij në përputhje me pikën M.A.302 me:

— organizatën për menaxhimin e përshtatshmërisë së vazhdueshme të operimit ajror të miratuar në përputhje me Seksionin A, Nën-pjesën G të kësaj Shtojce (Pjesa M), ose

— në rastin e avionëve ELA2, që nuk përfshihen në operacionet komerciale, Pjesa 145 ose M.A. Nën-pjesa F organizata e mirëmbajtjes,

Në këtë rast, kontrata e kufizuar bart përgjegjësinë për zhvillimin dhe, përveç rastit kur lëshohet ndonjë deklaratë nga pronari në përputhje me M.A.302 (h), procedimin e miratimit të programit të mirëmbajtjes të organizatës së kontraktuar.'

(3) Në pikën M.A.301, pika 3 zëvendësohet nga si në vijim:

‘3. realizimi i tërë mirëmbajtjes, në përputhje me programin M.A.302 për mirëmbajtjen e avionëve;’

(4) Pika M.A.302 është ndryshuar si në vijim:

(i) në pikën (c), fjalia e parë zëvendësohet nga si në vijim:

‘Kur përshtatshmëria e vazhdueshme e operimit ajror të avionit menaxhohet nga një organizatë për menaxhimin e përshtatshmërisë së vazhdueshme të operimit ajror të miratuar në përputhje me Seksionin A, Nën-pjesën G të kësaj Shtojce (Pjesa M), ose kur ekziston një kontratë e kufizuar midis pronarit dhe kësaj organizate në përputhje me pikën M.A.201 (e)(ii), programi i mirëmbajtjes së avionëve dhe ndryshimet e tij mund të miratohen përmes një procedure të miratimit të tërthortë.’

(ii) pikat në vijim (h) dhe (i) janë shtuar:

‘(h) Në rastin e avionëve ELA1, që nuk përfshihen në operacionet komerciale, pajtueshmëria me pikat (b), (c), (d), (e) dhe (g) mund të zëvendësohet në pajtim me të gjitha kushtet e mëposhtme:

1. Programi i mirëmbajtjes së avionëve identifikon qartë pronarin dhe avionin specifik, të cilit i referohet, duke përfshirë çdo motor dhe helikë të instaluar.

2. Programi i mirëmbajtjes së avionëve ose:

— përputhet me "Programin e Inspektimit Minimal", të përfshirë në pikën (i), që korrespondon me avionin përkatës, ose

— përputhet me pikat (d) dhe (e).

Programi i mirëmbajtjes nuk duhet të jetë më pak kufizues se "Programi i Inspektimit Minimal”.

3. Programi i mirëmbajtjes së avionëve përfshinë të gjitha kërkesat e detyrueshme të përshtatshmërisë së vazhdueshme të operimit ajror, siç janë direktivat e përsëritura të përshtatshmërisë së operimit ajror, Seksioni i kufizimit të përshtatshmërisë së operimit ajror (ALS) të udhëzimeve për përshtatshmërinë e vazhdueshme ajrore (ICA), ose kërkesat specifike të mirëmbajtjes që gjenden në regjistrin e të dhënave të llojit të certifikatës (TCDS).

Përveç kësaj, programi i mirëmbajtjes së avionëve identifikon çdo detyrë shtesë të mirëmbajtjes që do të kryhet për shkak të llojit të avionit specifik, konfigurimit të avionëve dhe llojit dhe specificitetit të operimit. Elementet e mëposhtme do të merren parasysh si minimum:

— Pajisje specifike të instaluara dhe modifikimet e avionit.

— Riparimet e përfshira në avion.

— Komponentët me jetëgjatësi të kufizuar dhe komponentët kritike të sigurisë së fluturimit.

— Rekomandimet e mirëmbajtjes, siç janë intervalet e kohës së rregullimit (TBO), të rekomanduara përmes buletineve të shërbimit, letrave të shërbimit dhe informacioneve të tjera të shërbimit jo të detyrueshëm.

— Direktivat / kërkesat operacionale të aplikueshme lidhur me inspektimin periodik të pajisjeve të caktuara.

— Miratimet e veçanta operacionale.

— Përdorimi i avionit dhe mjedisit operacional.

— Mirëmbajtjet nga piloti-pronari (nëse aplikohet).

4. Nëse programi i mirëmbajtjes nuk aprovohet nga autoriteti kompetent (direkt ose nga organizata M.A. e Nën-pjesës G nëpërmjet një procedure të miratimit të tërthortë), programi i mirëmbajtjes së avionit duhet të përmbajë një deklaratë të nënshkruar ku pronari deklaron se ky është programi i mirëmbajtjes së avionëve për regjistrimin e avionëve specifik dhe ai/ajo deklaron se është plotësisht përgjegjës për përmbajtjen e tij dhe në veçanti për çdo devijim të paraqitur në lidhje me rekomandimet e mbajtësit të aprovimit të projektimit.

5. Programi i mirëmbajtjes së avionëve do të rishikohet së paku një herë në vit. Ky rishikim i programit të mirëmbajtjes do të kryhet ose:

— nga personi që kryen rishikimin e përshtatshmërisë së operimit ajror të avionit në përputhje me pikën M. A.710 (ga), ose

— nga organizata M.A. e Nën-pjesës G që menaxhon përshtatshmërinë e vazhdueshme të operimit ajror, në ato raste kur rishikimi i programit të mirëmbajtjes nuk kryhet së bashku me rishikimin e përshtatshmërisë së operimit ajror.

Nëse rishikimi tregon mospërputhje në avion lidhur me mangësitë në përmbajtjen e programit të mirëmbajtjes, personi që kryen rishikimin duhet të informojë autoritetin kompetent të Shtetit Anëtar të regjistrimit dhe pronari duhet të ndryshojë programin e mirëmbajtjes siç është rënë dakord me këtë autoritet kompetent.

(i) Në rastin e avionëve ELA1 përveç fluturakeve me ajër që nuk janë të përfshira në operacione komerciale, "Programi i Inspektimit Minimal" i përmendur në pikën (h) duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

1. Ai duhet të përmbajë intervalet e mëposhtme të inspektimit:

— Për aeroplanët ELA1 dhe ELA1 Planer të udhëtimit me motor (TMG), në bazë vjetore apo pas një intervali prej 100 orësh, cilado që të jetë e para. Mund të aplikohet një tolerancë prej 1 muaj ose 10 orë për atë interval, për aq kohë sa intervali i ardhshëm të llogaritet nga data ose orët e planifikuara fillimisht.

— Për fluturaket me planer ELA1, fluturaket planer me motor ELA1 në vend të balonave ELA1 dhe TMG, në bazë vjetore. Mund të aplikohet një tolerancë prej 1 muaj në atë interval, për aq kohë sa intervali i ardhshëm të llogaritet nga data e planifikuar fillimisht.

2. Ajo përmban si në vijim:
   — Detyrat e servisimit, siç kërkohet me kërkesat e mbajtësit të aprovimit të projektimit.
   — Inspektimi i shenjave.
   — Shqyrtimi i regjistrave të peshimit dhe peshimi në përputhje me Rregulloren e Komisionit (BE) Nr. 965/2012 (*), pika NCO.POL.105.
   — Testi operacional i transponderit (nëse ekziston).
   — Testi operacional i sistemit pitot statik.
   — Në rastin e aeroplanëve ELA1:
      — Kontrollet operacionale për fuqinë dhe rpm, magnetot, presionin e karburantit dhe të naftës, temperaturat e motorit.
      — Për motorët e pajisur me kontroll automatik të motorit, procedura e përshpejtuar.
      — Për motorët me tharje, motorët me turbina dhe motorët me lëng ftohës, një kontroll operacional për shenjat e qarkullimit të çrregulluar të lëngjeve.
   — Inspektimi i gjendjes dhe lidhja e pjesëve strukturore, sistemeve dhe komponentëve që korrespondojnë me fushat e mëposhtme:
      — Për aeroplanët ELA1:
         — Trupi i avionit
         — Kabina e pilotit
         — Mekanizmi i aterrimit
         — Pjesa e krahut dhe ajo qendrore
         — Kontrollet e fluturimit
         — Bishti i avionit
         — Instrumentet dhe elektrika i avionit
         — Kutia elektrike
         — Freksinet dhe kutia e marshit
         — Helika
         — Sistemet e ndryshme siç janë sistemi balistik i shpëtimit
      — Për fluturaket me planer ELA1 dhe fluturaket planer me motor ELA1:
         — Trupi i fluturakes
         — Kabina e pilotit
         — Pajisjet e aterrimit
         — Pjesa e krahut dhe ajo qendrore
         — Bishti i fluturakes
         — Instrumentet dhe elektrika e fluturakes
         — Kutia elektrike (nëse aplikohet)
         — Sistemet ndryshme siç janë balasti që mund të hiqet, parashuta e frenimit dhe kontrollet, si dhe sistemi balast i ujit

      — Për balonat me ajër të nxehtë ELA1:
         — Mbështjellësi
         — Ndezësi
         — Koshi
         — Kontejnerët e karburantit
         — Pajisjet dhe instrumentet

— Për balonat me gaz ELA1:
  — Mbështjellësi
  — Koshi
  — Pajisjet dhe instrumentet

Përderisa kjo Rregullore përcakton një "Program të Inspektimit Minimal" për fluturaket me ajër, programi i tyre i mirëmbajtjes duhet të jetë në përputhje me pikat (d) dhe (e).

(*) Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 965/2012, e datës 5 tetor 2012, që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative të ndërlidhura me operacionet ajrore sipas Rregullores (KE) Nr. 216/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (GZ L 296, 25.10.2012, f. 1).'

(5) Në pikën M.A.604 pika (a), pikat 5 dhe 6 zëvendësohen nga si në vijim:

'5. një listë të stafit certifikues dhe, nëse është e aplikueshme, stafi i rishikimit të përshtatshmërisë së operimit ajror dhe stafi përgjegjës për zhvillimin dhe përpunimin e programit të mirëmbajtjes, me fushëveprimin e tyre të miratimit dhe;

6. një listë të lokacioneve ku kryhet mirëmbajtja, së bashku me një përshkrim të përgjithshëm të objekteve, dhe;'

(6) Pika M.A.606 është ndryshuar si në vijim:

(i) Pika (e) zëvendësohet nga si në vijim:

'(e) Kualifikimi i gjithë personelit të përfshirë në mirëmbajtjen, rishikimet e përshtatshmërisë së operimit ajror dhe zhvillimi i programeve të mirëmbajtjes duhet të demonstrohen dhe regjistrohen.'

(ii) Janë shtuar pikat e mëposhtme (i) dhe (j):
'(i) Nëse organizata kryen rishikimet e përshtatshmërisë së operimit ajror dhe lëshon certifikatën përkatëse të rishikimit të përshtatshmërisë së operimit ajror për avionët ELA1 që nuk përfshihen në operacionet komerciale në përputhje me M.A.901 (l), ajo duhet të ketë personelin e rishikimit të përshtatshmërisë së operimit ajror të kualifikuar dhe autorizuar në përputhje me M.A.901(l)1.

(j) Nëse organizata është e përfshirë në zhvillimin dhe procedimin e miratimit të programit të mirëmbajtjes për avionët ELA2 që nuk janë të përfshirë në operacione komerciale në përputhje me MA201 (e)(ii), ajo duhet të ketë staf të kualifikuar i cili është në gjendje të shfaqë njohuritë dhe përvojën përkatëse.'

(7) Pika M.A.607 është ndryshuar si në vijim:

(i) Titulli është zëvendësuar nga si në vijim:

'M.A.607 Stafi i Certifikimit dhe stafi për rishikimin e përshtatshmërisë së operimit ajror'

(ii) Në pikën (b), fjalia e parë e nën-paragrafit të dytë është zëvendësuar nga si në vijim:

‘Të gjitha rastet e tilla duhet t'i raportohen autoritetit kompetent brenda shtatë ditëve pas lëshimit të autorizimit të tillë të certifikimit.’

(iii) Pika (c) zëvendësohet nga si në vijim:

‘(c) Organizata e mirëmbajtjes e miratuar regjistron të gjitha detajet lidhur me personelin certifikues dhe personelin e rishikimit të përshtatshmërisë së operimit ajror, si dhe të mbajë një listë aktuale tërë personelit certifikues dhe personelit të rishikimit të përshtatshmërisë së operimit ajror, së bashku me fushëveprimin e tyre të aprovimit, si pjesë e manualit të organizatës sipas pikës M.A.604(a)5.’

(8) Pika M.A.614 është ndryshuar si në vijim:

(i) Titulli zëvendësohet nga si në vijim:

‘M.A.614 Regjistrat e mirëmbajtjes dhe rishikimit të përshtatshmërisë së operimit ajror’

(ii) Pika (a) zëvendësohet nga si në vijim:

‘(a) Organizata e miratuar e mirëmbajtjes regjistron të gjitha detajet e punës së kryer. Duhet mbajtur regjistrat e nevojshme për të vërtetuar se të gjitha kërkesat janë plotësuar për lëshimin e certifikatës së lëshimit në shërbim, duke përfshirë lëshimin e dokumenteve të nën-kontraktuesit dhe për lëshimin e certifikatës së rishikimit të përshtatshmërisë së operimit ajror dhe rekomandimet.’

(iii) Pika (c) zëvendësohet nga si në vijim:

‘(c) Organizata e miratuar e mirëmbajtjes duhet të ruaj një kopje të të gjitha të dhënave të mirëmbajtjes si dhe të të dhënave përkatëse të mirëmbajtjes për tri vite nga data kur avioni apo komponenti i avionit me të cilin lidhet puna është lëshuar nga organizata e miratuar e mirëmbajtjes. Përveç kësaj, ajo ruan një kopje të të gjitha të dhënave në lidhje me lëshimin e rekomandimeve dhe certifikatave të rishikimit të përshtatshmërisë së operimit ajror për tri vite nga data e lëshimit dhe një kopje të saj ia ofron pronarit të avionit.

1. Të dhënat e regjistruara sipas kësaj pike duhet të ruhen në atë mënyrë që të sigurojë mbrojtje nga dëmtimet, ndryshimet dhe vjedhjet.

2. Tërë hardueri kompjuterik i përdorur për të siguruar përforcimin duhet të ruhet në një vend tjetër nga ai që përmban të dhënat e punës në një ambient ku ato nuk dëmtohen.

3. Kur një organizatë e miratuar e mirëmbajtjes përfundon punën e saj, të gjitha shënimet e ruajtura të mirëmbajtjes që mbulojnë tre vitet e fundit duhet t'i shpërndahen pronarit ose klientit të fundit të avionit ose komponentit përkatës ose duhet të ruhen siç përcaktohet nga autoriteti kompetent.’

(9) Në pikën M.A.615, shtohen pikat (e) dhe (f):

‘(e) nëse është aprovuar posaçërisht për ta bërë këtë për avionët ELA1 që nuk përfshihen në operacionet komerciale,

1. kryen rishikimet e përshtatshmërisë së operimit ajror dhe lëshon certifikatën përkatëse të rishikimit të përshtatshmërisë së operimit ajror, sipas kushteve të përcaktuara në pikën M.A.901 (l), dhe

2. kryen rishikimet e përshtatshmërisë së operimit ajror dhe lëshon rekomandimet përkatëse, sipas kushteve të përcaktuara në pikën M.A.901(l) dhe M.A.904(a)2 dhe (b).

(f) zhvillon programin e mirëmbajtjes dhe procedon miratimin e tij në përputhje me pikën M.A.302 për avionët ELA2 që nuk janë të përfshirë në operacione komerciale, sipas kushteve të specifikuara në pikën M.A.201 (e)(ii) dhe të kufizuara në kategorizimin e avionëve të listuar në certifikatën e miratimit.

Organizata duhet të mirëmbajë vetëm një avion ose komponent për të cilin është i aprovuar kur janë në dispozicion të gjitha hapësirat, pajisjet, veglat, materialet, të dhënat e mirëmbajtjes dhe personeli certifikues i nevojshëm.'

(10) Në pikën M.A.617, pika 6 zëvendësohet si vijon:

'6. Hapësirat, pajisjet, veglat, materialet, procedurat, fushëveprimin e punës, personeli i certifikuar dhe personeli i rishikimit të përshtatshmërisë së operimit ajror që mund të ndikojë në miratimin.'

(11) Në pikën M.A.707, pika (b) zëvendësohet nga si në vijim:

'(b) Stafit të rishikimit të përshtatshmërisë së operimit ajror, i emëruar nga organizata e miratuar e përshtatshmërisë së vazhdueshme të operimit ajror, mund t'i lëshohet një autorizim vetëm nga organizata e miratuar e përshtatshmërisë së vazhdueshme të operimit ajror, kur pranohet zyrtarisht nga autoriteti kompetent pas përfundimit të kënaqshëm të rishikimit të përshtatshmërisë së operimit ajror nën mbikëqyrjen e autoritetit kompetent ose nën mbikëqyrjen e stafit të rishikimit të përshtatshmërisë së operimit ajror të organizatës në përputhje me një procedurë të miratuar nga autoriteti kompetent.'

(12) Pika M.A.710 është ndryshuar si në vijim:

(i) Pika e mëposhtme (ga) është futur pas pikës (g):

'(ga) Për avionët e ELA1 që nuk përfshihen në operacionet komerciale për të cilat është themeluar programi i mirëmbajtjes së avionëve në përputhje me M.A.302 (h), programi i mirëmbajtjes së avionëve do të rishikohet së bashku me rishikimin e përshtatshmërisë së operimit ajror. Ky rishikim kryhet nga personi që ka kryer rishikimin e përshtatshmërisë së operimit ajror.'

(ii) Pika (h) zëvendësohet nga si në vijim:

'(h) Nëse rezultati i rishikimit të përshtatshmërisë së operimit ajror nuk është i bindshëm ose nëse rishikimi sipas pikës MA710 (ga) tregon mospërputhje për avionin lidhur me mangësitë në përmbajtjen e programit të mirëmbajtjes, autoriteti kompetent duhet të informohet nga organizata sa më shpejt që është e mundur, por jo më vonë 72 orë nga momenti kur organizata identifikon gjendjen me të cilën lidhet rishikimi. Certifikata e rishikimit të përshtatshmërisë së operimit ajror nuk lëshohet deri sa të korrigjohen të gjitha problemet e gjetura.'

(13) Pika M.A.901 është ndryshuar si në vijim:

(i) Pika (a) zëvendësohet nga si në vijim:

‘(a) Certifikata e rishikimit të përshtatshmërisë së operimit ajror lëshohet në përputhje me Shtesën III (Formularët EASA 15a, 15b ose 15c) pas përfundimit të rishikimit të përmbushjes së përshtatshmërisë së operimit ajror. Certifikata e rishikimit të përshtatshmërisë së operimit ajror është e vlefshme një vit;’

(ii) Pika e mëposhtme (l) është shtuar:

‘(l) Për avionët ELA1 që nuk përfshihen në operacionet komerciale, Pjesa 145 ose organizata e mirëmbajtjes M.A, Nën-pjesa F e cila kryen inspektimin vjetor të përfshirë në programin e mirëmbajtjes, nëse është e miratuar siç duhet, mund të kryejë rishikimin e përshtatshmërisë së operimit ajror dhe për lëshimin e certifikatës përkatëse të rishikimit të përshtatshmërisë së operimit ajror, që i nënshtrohet këtyre kushteve:

1. Organizata emëron stafin e rishikimit të përshtatshmërisë së operimit ajror në përputhje me të gjitha kërkesat e mëposhtme:

   (a) Stafi i rishikimit të përshtatshmërisë së operimit ajror posedon autorizimin e stafit certifikues për avionin përkatës.

   (b) Stafi i rishikimit të përshtatshmërisë së operimit ajror ka së paku tri vite përvojë profesionale si staf certifikues.

   (c) Stafi i rishikimit të përshtatshmërisë së operimit ajror është i pavarur nga procesi i menaxhimit të përshtatshmërisë së vazhdueshme të operimit ajror të avionit që shqyrtohet ose ka autoritetin e përgjithshëm për procesin e menaxhimit të përshtatshmërisë së vazhdueshme të operimit ajror të tërë avionit nën rishikim.

   (d) Stafi i rishikimit të përshtatshmërisë së operimit ajror ka marrë njohuri për pjesët e kësaj Shtojce (Pjesa M), që është relevante për menaxhimin e përshtatshmërisë së vazhdueshme të operimit ajror.

   (e) Stafi i rishikimit të përshtatshmërisë së operimit ajror ka marrë njohuri të dëshmuara për procedurat e organizatës së mirëmbajtjes, që është relevante për rishikimin e përshtatshmërisë së operimit ajror dhe për lëshimin e certifikatës së rishikimit të përshtatshmërisë së operimit ajror.

   (f) Stafi i rishikimit të përshtatshmërisë së operimit ajror është pranuar zyrtarisht nga autoriteti kompetent pasi ka kryer një rishikim të përshtatshmërisë së operimit ajror nën mbikëqyrjen e autoritetit kompetent ose nën mbikëqyrjen e stafit të rishikimit të përshtatshmërisë së operimit ajror të organizatës në përputhje me procedurën e miratuar nga autoriteti kompetent.

   (g) Stafi i rishikimit të përshtatshmërisë së operimit ajror ka kryer së paku një rishikim të përshtatshmërisë së operimit ajror në 12 muajt e fundit.

2. Rishikimi i përshtatshmërisë së operimit ajror kryhet në të njëkohësisht me inspektimin vjetor të përfshirë në programin e mirëmbajtjes dhe nga i njëjti person i cili liron inspektimin e tillë vjetor, duke mundësuar përdorimin e dispozitës së parashikuar prej 90 ditësh e përfshirë në M.A.710(d).

3. Rishikimi i përshtatshmërisë së operimit ajror përfshinë rishikimin e plotë të dokumentuar në pajtim me pikën M.A.710(a).

4. Rishikimi i përshtatshmërisë së operimit ajror përfshinë vëzhgimin fizik të avionit në përputhje me pikat M.A.710(b) dhe (c).

5. Formulari i certifikatës së rishikimit të përshtatshmërisë së operimit ajror EASA 15 c lëshohet në emër të organizatës së mirëmbajtjes nga personi që ka kryer rishikimin e përshtatshmërisë së operimit ajror kur bindet se:

   (a) është kryer rishikimi i përshtatshmërisë së operimit ajror në mënyrë të plotë dhe në mënyrë të kënaqshme; dhe

   (b) është rishikuar programi i mirëmbajtjes në përputhje me pikën M.A.710 (ga); dhe

   (c) nuk ka ndonjë mospërputhje e cila njihet se paraqet rrezik për sigurinë e fluturimit.

6. Një kopje e lëshuar e certifikatës së rishikimit të përshtatshmërisë së operimit ajror i dërgohet autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar të Regjistrit të avionit brenda 10 ditëve nga data e lëshimit.

7. Autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të Regjistrit njoftohet brenda 72 orëve nëse organizata ka konstatuar se rishikimi i përshtatshmërisë së operimit ajror është e papërfunduar ose nëse rishikimi sipas pikës MA901 (l) 5 (b) tregon mospërputhje të avionit lidhur me mangësitë në përmbajtjen e programit të mirëmbajtjes.

8. Manuali ose ekspozeu i organizatës së mirëmbajtjes i përshkruan të gjitha këto në vijim:

   (a) Procedurat për kryerjen e rishikimeve të përshtatshmërisë së operimit ajror dhe për lëshimin e certifikatës përkatëse të rishikimit të përshtatshmërisë së operimit ajror.

   (b) Emrat e stafit certifikues të autorizuar për të kryer rishikimet e përshtatshmërisë së operimit ajror dhe për lëshimin e certifikatës përkatëse të rishikimit të përshtatshmërisë së operimit ajror.

   (c) Procedurat për rishikimin e programit të mirëmbajtjes.'

(14)Në pikën M.A.904, pika (b) zëvendësohet nga si në vijim:

'(b) Kur bindet se avioni është në përputhje me kërkesat përkatëse, organizata për menaxhimin e përshtatshmërisë së vazhdueshme të operimit ajror ose organizata e mirëmbajtjes, nëse është e zbatueshme, dërgon një rekomandim të dokumentuar për lëshimin e një certifikate të rishikimit të përshtatshmërisë së operimit ajror në Shtetin Anëtar të Regjistrit.'

(15) Pika M.B.301 zëvendësohet nga si në vijim: ‘M.B.301 Programi i mirëmbajtjes

(a) Përveç rasteve kur pronari ka lëshuar një deklaratë për programin e mirëmbajtjes në përputhje me pikën M.A.302 (h), autoriteti kompetent verifikon nëse programi i mirëmbajtjes është në përputhje me pikën M.A.302.

(b) Përveç kur parashikohet ndryshe në pikat M.A.302 (c) dhe M.A.302 (h) programi i mirëmbajtjes dhe ndryshimet e tij miratohen drejtpërdrejt nga autoriteti kompetent.

(c) Në rast të miratimit të tërthortë, procedura e programit të mirëmbajtjes miratohet nga autoriteti kompetent përmes ekspozeut të menaxhimit të përshtatshmërisë së vazhdueshme të operimit ajror.

(d) Për të miratuar programin e mirëmbajtjes sipas pikës (b) të kësaj pike, autoriteti kompetent do të ketë qasje në të gjitha të dhënat e kërkuara në pikat MA302 (d), (e), (f) dhe (h)’

(16) Në Shtesën II, pika 5 është ndryshuar si në vijim:

(i) Pika (x) e Bllokut 12 Shënimet zëvendësohet nga si në vijim:

‘(x) Për organizatat e mirëmbajtjes të miratuara në përputhje me Nën-pjesën F të Shtojcës I (Pjesa M), certifikata përbërëse e deklaratës për lëshimin në shërbim të përmendur në pikën M.A.613:

“Vërteton që, përveç nëse specifikohet ndryshe në këtë bllok, puna e identifikuar në Bllokun 11 dhe e përshkruar në këtë bllok është kryer në përputhje me kërkesat e Seksionit A, Nën-pjesa F e Shtojcës I (Pjesa M) e Rregullores (BE) Nr. 1321/2014 dhe në lidhje me atë punë, artikulli konsiderohet si i gatshëm për lëshuarje në shërbim. KJO NUK ËSHTË NJË LËSHUARJE SIPAS SHTOJCËS II (PJESA-145) TË RREGULLORES (BE) Nr. 1321/2014”’

(ii) Blloku 14a zëvendësohet nga si në vijim:

‘Shënjoni rubrikën(-at) e duhura për të treguar se cilat rregulla zbatohen për punën e përfunduar. Nëse shënjohet rubrika "rregulla të tjera të specifikuara në bllokun 12", atëherë duhet të identifikohen rregulloret e autoriteteve të tjera të përshtatshmërisë së operimit ajror në bllokun 12. Të paktën një rubrikë duhet të shënjohet ose, sipas nevojës, mund të shënjohen të dyja rubrikat.

Për të gjitha mirëmbajtjet e kryera nga organizatat e mirëmbajtjes të miratuara në përputhje me Seksionin A, Nën-pjesën F të Shtojcës I (Pjesa M) e Rregullores (BE) Nr. 1321/2014, duhet të plotësohet rubrika "rregulloret tjera të specifikuara në bllokun 12" dhe deklarata e certifikatës së lëshimit në shërbim të bërë në bllokun 12. Në këtë rast, deklarata e certifikimit "përveç nëse specifikohet ndryshe në këtë bllok" ka për qëllim të adresojë rastet e mëposhtme;

(a) Kur mirëmbajtja nuk ka mundur të përfundohet.

(b) Kur mirëmbajtja ka devijuar nga standardi i kërkuar sipas Shtojcës I (Pjesa-M).

(c) Kur mirëmbajtja është kryer në përputhje me një kërkesë ndryshe nga ajo e specifikuar në Shtojcën I (Pjesa-M). Në këtë rast blloku 12 specifikon rregulloren e veçantë kombëtare.

Për të gjitha mirëmbajtjet e kryera nga organizatat e mirëmbajtjes të miratuara në përputhje me Seksionin A të Shtojcës II (Pjesa-145) të Rregullores (EU) Nr. 1321/2014, deklarata e certifikimit "përveç nëse është specifikuar ndryshe në bllokun 12" ka për qëllim të adresojë rastet e mëposhtme:

(a) Kur mirëmbajtja nuk ka mundur të përfundohet.

(b) Kur mirëmbajtja ka devijuar nga standardi i kërkuar nga Shtojca I I (Pjesa-145).

(c) Kur mirëmbajtja është kryer në përputhje me një kërkesë ndryshe nga ajo e specifikuar në Shtojcën II (Pjesa-145). Në këtë rast blloku 12 specifikon rregulloren e veçantë kombëtare.'

(17) Shtesa III është ndryshuar si në vijim:

(i) Formulari EASA 15b dhe Formulari EASA 15a zëvendësohen nga si në vijim:

[SHTETI ANËTARË]

Anëtarë i Bashkimit Evropian (*)

CERTIFIKATA E RISHIKIMIT TË PËRSHTATSHMËRISË SË OPERIMIT AJROR

Referenca CRPOA:.....

Në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 216/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e cila aktualisht është në fuqi, organizata e mëposhtme e menaxhimit të përshtatshmërisë së vazhdueshme të operimit ajror, e miratuar në përputhje me Seksionin A, Nën-pjesën G të Shtojcës I (Pjesa M) së Rregullores së Komisionit (BE) Nr. 1321/2014.

[EMRI DHE ADRESA E ORGANIZATËS SË MIRATUAR]

Referenca e miratimit: [KODI I SHTETIT ANËTARË].MG.[NNNN].

me anë të kësaj vërteton se ka kryer një rishikim të përshtatshmërisë së operimit ajror në përputhje me pikën M.A.710 të Shtojcës I të Rregullores së Komisionit (BE) Nr. 1321/2014

Prodhuesi i avionit:.....

Emërtimi i Prodhuesit:.....

Regjistrimi i avionit:.....

Numri serik i avionit:.....

dhe ky avion konsiderohet i përshtatshëm për operim ajror në kohën e rishikimit.

Data e lëshimit:..... Data e skadimit:.....

Orët e fluturimit të trupit të avionit (OF) në datën e lëshimit(**).....

Nënshkruar:..... Nr. i autorizimit:.....

Vazhdimi i 1-rë: Gjatë vitit të kaluar avioni ka qëndruar në një mjedis të kontrolluar në përputhje me pikën M.A.901 të Shtojcës I të Rregullores së Komisionit (BE) Nr. 1321/2014. Avioni konsiderohet të jetë i përshtatshëm për operim ajror kohën e lëshimit të certifikatës:.

Data e lëshimit:..... ..... Data e skadimit:.....

Orët e fluturimit të trupit të avionit (OF) në datën e lëshimit(**)

Nënshkruar:..... Nr. i autorizimit:.....

Emri i kompanisë:..... Referenca e Miratimit

Vazhdimi i 2-të: Gjatë vitit të kaluar avioni ka qëndruar në një mjedis të kontrolluar në përputhje me pikën M.A.901 të Shtojcës I të Rregullores së Komisionit (EU) Nr. 1321/2014. Avioni konsiderohet të jetë i përshtatshëm për operim ajror në kohën e lëshimit të certifikatës:

Data e lëshimit:..... Data e skadimit:.....

Orët e fluturimit të trupit të avionit (OF) në datën e lëshimit(**)

Nënshkruar:..... Nr. i autorizimit:.....

Emri i kompanisë:..... Referenca e Miratimit.....

Formulari 15b EASA, Botimi 4

(*) Fshijeni për shtetet jo anëtarë të BE-së

(**) Përveç Balonave dhe Fluturakeve me ajër

[SHTETI ANËTARË]

Anëtarë i Bashkimit Evropian (*)

CERTIFIKATA E RISHIKIMIT TË PËRSHTATSHMËRISË SË OPERIMIT AJROR

Referenca CRPOA:.....

Në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 216/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e cila aktualisht është në fuqi, [AUTORITETI KOMPETENT I SHTETIT ANËTARË] me anë të kësaj vërteton se avioni si në vijim:

Prodhuesi i avionit:.....

Emërtimi i Prodhuesit:.....

Regjistrimi i avionit:.....

Numri serik i avionit:.....

konsiderohet i përshtatshëm për operim ajror në kohën e rishikimit.

Data e lëshimit:..... Data e skadimit:.....

Orët e fluturimit të trupit të avionit (OF) në datën e lëshimit(**).....

Nënshkruar:..... Nr. i autorizimit:.....

Vazhdimi i 1-rë: Gjatë vitit të kaluar avioni ka qëndruar në një mjedis të kontrolluar në përputhje me pikën M.A.901 të Shtojcës I të Rregullores së Komisionit (BE) Nr. 1321/2014. Avioni konsiderohet të jetë i përshtatshëm për operim ajror në kohën e lëshimit të certifikatës.

Data e lëshimit:..... Data e skadimit:.....

Orët e fluturimit të trupit të avionit (OF) në datën e lëshimit(**)

Nënshkruar:..... Nr. i autorizimit:.....

Emri i kompanisë:..... Referenca e Miratimit:.....

Vazhdimi i 2-të: Gjatë vitit të kaluar avioni ka qëndruar në një mjedis të kontrolluar në përputhje me pikën M.A.901 të Shtojcës I të Rregullores së Komisionit (BE) Nr. 1321/2014. Avioni konsiderohet të jetë i përshtatshëm për operim ajror në kohën e lëshimit të certifikatës:

Data e lëshimit:..... Data e skadimit:.....

Orët e fluturimit të trupit të aeroplanit (OF) në datën e lëshimit(**)

Nënshkruar:..... Nr. i autorizimit:.....

Emri i kompanisë:..... Referenca e Miratimit:.....

Formulari EASA 15b, Botimi 4

(*) Fshijeni për shtetet jo anëtarë të BE-së

(**) Përveç Balonave dhe Fluturakeve me ajër

(ii) Formulari i mëposhtëm EASA 15c është shtuar:

[SHTETI ANËTARË]

Anëtarë i Bashkimit Evropian (*)

CERTIFIKATA E RISHIKIMIT TË PËRSHTATSHMËRISË SË OPERIMIT AJROR (**)
Referenca CRPOA:.....
Në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 216/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e cila aktualisht është në fuqi, organizata e mëposhtme e mirëmbajtjes e miratuar në përputhje me (shënoni siç është e zbatueshme):

☐ Seksioni A, Nën-pjesa F e Shtojcës I (Pjesa M) e Rregullores së Komisionit (BE) Nr. 1321/2014, ose
☐ Seksioni A i Shtojcës II (Pjesa 145) e Rregullores së Komisionit (BE) Nr. 1321/2014.

